



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA-SHTIME/OPSTINA-STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**

02 Nr. 422

Dt.08.08.2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53, Ligjit nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr 03/L-205, neni 83 dhe 123 të Ligjit nr. 05/L- 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit të Kuvendit Komunal – Shtime Npi 01/155 datë 28.06.2018, Kryetari i Komunës mori këtë:

V E N D I M - P R E L I M I N A R

- 1. Aprovohet** kërkesa e Komunitetit të Lagjës Ademaj, për shpronësimin e patundshmërisë për interes publik dhe atë pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72809066-00480-0, në sipërfaqe prej 2575 m², Zona Kadastrale – Shtime të pronarëve, shfrytëzuesve dhe zotëruesve të interesit të cilët preken me zgjerimin e lokacionit të varrezave për lagjen Ademaj, sipas tabelës të bashkangjitur të këtij vendimi.
- 2. Obligohet** Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike që brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi – preliminar, të njoftoj pronarët e pronës së patundshme dhe zotëruesit e interesit e cila do të shpronësohet dhe brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve të punës pas aprovimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
- 3.** Kundër këtij vendimi apo cilësdo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkuar dhe cildo person i cili është pronarë, apo zotërues i interesit në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
- 4.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Zyra Kryesore Financiare (ZKF).
- 5.** Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Palës
- Zyrës Kryesore Financiare
- Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi
- Arhives.

Kryetari i Komunës:
Naim Ismajli



Tabela mbi shpronësimin në bazë të vendimit Preliminarë nr 02 nr 422, datë 08.08.2018

Komuna Shtime – Zona Kadastrale –Petrovë							
Nr	Pronarë	Nr.i ngastrës	Kultura -klasa	Sipërfaqja e përgjithshme m ²	Sipërfaqja për shpronësim m ²	Sipërfaqja e mbetur m ²	Vërejtje
1	Ademaj (Ali) Emrush nga Petrova, Komuna Shtime 1/1	P-72809093-00480-0	Arë/5	9185	2575	6610	